

AMF aderon në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar-Mars 2022
- Ecuria e tregut të Titujve të Qeverisë, Janar-Mars 2022

Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takohet me drejtues të grupit Intesa Sanpaolo dhe Eurizon Capital - interes për fonde investimi në Shqipëri
- FMN vlerëson qasjen rregullatore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Publikime Profesionale

- **BIS** Monedhat Dixhitale të Bankave Qendrore (CBDC) për njerëzit
- **Global Risk Regulator** Si firmat financiare mund t'i kthejnë rregullat e "Cloud" në avantazhin e tyre

Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Çeki
- Rumani
- Sllovaki
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF aderon në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka aderuar në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në funksion të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve.

Anëtarësimi i AMF në grupin e vendeve nënshkruese të MMoU-së është realizuar pas një procesi rigoroz verifikimi të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS.

Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit i ndihmon mbikëqyrësit, duke përcaktuar kuadrin formal të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, në drejtim të mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit.

Dr. Vicky Saporta, Kryetare e Komitetit Ekzekutiv të IAIS shprehu kënaqësinë e aderimit të Shqipërisë në grupin e vendeve nënshkruese të MMoU. “Në mënyrë që të arrihet objektivi ynë kryesor, mbrojtja e konsumatorëve brenda tregut global të sigurimeve, një autoritet mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve duhet të jetë në gjendje të bashkëpunojë në mënyrë të shpejtë dhe efektive. MMoU është një mjet rregullator thelbësor për mbikëqyrësit në promovimin e tregjeve të sigurimeve më të sigurta dhe më të qëndrueshme”.

“Aderimi në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) është finalizimi i një procesi të gjatë të rishikimit ligjor e rregullator për Autoritetin. Bashkëpunimi i ngushtë dhe shkëmbimi i informacionit mes rregullatorëve vlerësohet si shumë i rëndësishëm, edhe në kuadër të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimit dhe në kuadër të aktiviteteve ndërkufitare.” – u shpreh Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete.

Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit të IAIS përfaqëson një kuadër global përputhshmërie dhe konfidencialiteti, që i hap rrugën bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve të tregut të sigurimeve. Përmes anëtarësimit në grupin e nënshkrueseve të MMoU-së, ku bëjnë pjesë 77 shtete dhe entitete (nga 152 anëtarë të IAIS), AMF mund të shkëmbejë informacion dhe të japë ose përfitojë asistencë nga nënshkruerit e tjerë, në funksion të stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes efektive të tregut të sigurimeve, AMF ka aderuar në IAIS në vitin 2001.

Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit të IAIS përfaqëson një kuadër global përputhshmërie dhe konfidencialiteti, që i hap rrugën bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve të tregut të sigurimeve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar–Mars 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-mars 2022 kapën vlerën 4,280 milionë lekë, ose 5.97% më shumë se në janar-mars 2021. Gjatë periudhës janar-mars 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 247,576 me një rritje prej 21.99% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.51% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.45%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.57% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.43% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,458 milionë lekë, ose 27.37% më pak se në periudhën janar-mars 2021, kjo ulje është e ndikuar nga vazhdimësia e pagesave për dëmshpërblime nga tërmetet e fund vitit 2019 gjatë janar-marsit 2021.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-mars 2022 kapën vlerën 1,003 milionë lekë, duke pësuar një rënie me rreth 0.63% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Mars 2022 (Në %)

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.51% të vëllimit të përgjithshëm të primeve



Ecuria e tregut të Titujve të Qeverisë, Janar-Mars 2022

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-mars 2022, u dominua në masën 69.43% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 30.57% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 78.44% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për periudhën janar–mars 2022, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 57.97% dhe 26.20% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar–mars 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.00% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar–mars 2022, ka pasur një rritje prej 848 milionë lekë ose 88.18% krahasuar me periudhën janar–mars 2021. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 32.10%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar–mars 2022, ka pasur një rritje prej 283 milionë lekë ose 61.84%, gjithashtu pati rritje në numrin e transaksioneve në masën 17.45%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 1,131 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar–mars 2021.

Tregu i Titujve të Qeverisë, Janar-Mars 2022 (Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për periudhën janar–mars 2022 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takohet me drejtues të grupit Intesa Sanpaolo dhe Eurizon Capital - interes për fonde investimi në Shqipëri



5 prill 2022 – Takim i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF me drejtues të grupit Intesa Sanpaolo dhe Eurizon Capital

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me drejtues të Grupit Intesa Sanpaolo, pjesë e të cilit është Eurizon Capital, shoqëri administruuese e fondeve të investimit, e renditur e dyta në Itali për vlerë asetesh neto. Temë e takimit ishin mundësitë e aksesit për investitorin shqiptar në fondet e investimit të shoqërisë Eurizon Capital, nëpërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Në fjalën e mbajtur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së vuri në dukje se ligji i ri “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” krijon për herë të parë mundësinë e marketimit dhe shpërndarjes së drejtpërdrejtë të fondeve europiane, të licencuara në BE, për investitorët në Shqipëri. Z. Mete theksoi se prania e emrave të njohur ndërkombëtarë në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Shqipëri sjell rritje të standardeve të tregut dhe më tepër hapësira e alternativa për investitorët.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, z. Alessandro D’Oria vlerësoi rolin e Autoritetit në drejtim të plotësimit të kuadrit të nevojshëm ligjor e rregullator, si edhe realizimin e procesit të përshtatshmërisë në zbatim të kërkesave të ligjit të ri. Z. D’Oria u shpreh se banka në rolin e distributorit synon t’u japë mundësinë klientëve shqiptarë të investojnë në fondet e investimeve të Eurizon Capital S.A. Ky shërbim i ri investimi do të ofrojë një mundësi të re për të aksesuar drejtpërdrejt tregun ndërkombëtar të menaxhimit të aseteve.

Pas miratimit të ligjit të ri “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” në vitin 2020 dhe plotësimit të gjithë kuadrit rregullator nga ana e Autoritetit, ka patur një interesim në rritje për fondet e reja të investimit. Gjatë vitit 2021, AMF licencoi dy fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, si edhe regjistroi dy fonde investimesh alternative. Në fund të vitit 2021, vlera neto e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive arriti në rreth 81.9 miliardë lekë, me një rritje prej 21.5% krahasuar me vitin 2020.

Ligji i ri “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” krijon për herë të parë mundësinë e marketimit dhe shpërndarjes së drejtpërdrejtë të fondeve europiane, të licencuara në BE, për investitorët në Shqipëri.

ZHVILLIME TË TJERA

FMN vlerëson qasjen rregullatore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare



Në kuadër të Takimeve të Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Washington, në sesionin me titull “Paraja Digjitale – Zhvillimi i Kapaciteteve për Ndërtimin e një Cikli Virtuoz”, ekspertët e FMN-së u ndalën tek rasti i Shqipërisë, si një nga vendet që ka miratuar një kuadër ligjor për asetet virtuale dhe ka qenë përfitues i asistencës teknike të FMN-së në këtë fushë. Ata vlerësuan qasjen rregullatore dhe përgatitjen e stafit të AMF-së përgjatë kohëzgjatjes së projektit të asistencës.


“Vitin e kaluar kemi ndërmarrë një mision të asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve në Shqipëri me fokus zbatimin efektiv të kuadrit ligjor në lidhje me krypto-asetet. Rrjedhimisht, kemi bashkëpunuar ngushtësisht me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si përfitues kryesor, i cili duhet thënë se ka një staf të mirëpërgatitur. Ekspertiza e FMN-së u fokusua në sfidat kryesore potenciale dhe implikimet në praktikë që mund të sjellë zbatimi i Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, me fokus të veçantë procesin e licencimit dhe disa aspekte të mbikëqyrjes financiare.”

Në përfundim, misioni i ekspertëve të FMN-së vërejtë se aktivitetet e lidhura me krypto-asetet në Shqipëri janë relativisht të ulëta në dukje, ndërkohë që miratimi i një kuadri ligjor mund të ndihmojë në legjitimimin e këtyre veprimtarive.

Më poshtë, gjeni linkun e sesionit “Paraja Digjitale – Zhvillimi i Kapaciteteve për Ndërtimin e një Cikli Virtuoz”:

https://www.youtube.com/watch?v=HBUmS9_Im0&feature=youtu.be

Misioni i ekspertëve të FMN-së vërejtë se aktivitetet e lidhura me krypto-asetet në Shqipëri janë relativisht të ulëta në dukje, ndërkohë që miratimi i një kuadri ligjor mund të ndihmojë në legjitimimin e këtyre veprimtarive”



Monedhat Dixhitale të Bankave Qendrore (CBDC) për njerëzit

CBDCs (Central Bank Digital Currencies) for the People

Op-ed

18 prill 2022

Z. Agustín Carstens, Drejtor i Përgjithshëm i BIS

H.M. Mbretëresha Máxima e Holandës, Avokatja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Financat Gjithëpërfshirëse për Zhvillim

Bankat qendrore në mbarë botën po shqyrtojnë nëse do të emetojnë monedhat e tyre dixhitale. Përfshirja financiare përmendet shpesh si një motivim kryesor, por kjo nuk arrihet në mënyrë automatike. Pikërisht si mund të ndërtohen monedhat dixhitale të bankës qendrore (CBDC) dhe si mund të zbatohen ato për të siguruar që njerëzit "pa bankë" të kenë akses në shërbimet thelbësore financiare?

Sipas Bankës Botërore, 1.7 miliardë të rritur në mbarë botën nuk janë të përfshirë në sistemin bankar. Pa akses në shërbime nga sektori financiar formal, ata janë të detyruar të përdorin alternativa, shpesh me kosto ose rrezik të konsiderueshëm. Një përjashtim i tillë financiar rrënjësor varfërinë, kufizon mundësitë dhe i pengon njerëzit të mbrohen nga vështirësitë. Ajo ngurtëson shpresën për një të ardhme më të mirë.

Përfshirja financiare fillon, por nuk përfundon, me aftësinë për të kryer dhe marrë pagesa. Njerëzit kanë nevojë për një mënyrë të shpejtë, të sigurt dhe të lirë për të transferuar para. Deri më sot, bankat qendrore e kanë përbushur në masë të madhe këtë nevojë duke ofruar formën më gjithëpërfshirëse të parasë që kemi aktualisht: paratë e gatshme (cash). Megjithatë, përdorimi ekskluzivisht i parave të gatshme i lë personat pa akses në banka jashtë sistemit financiar formal dhe pa të dhënat dhe gjurmët e transaksioneve të nevojshme për të aksesuar lehtësisht shërbimet financiare. Kjo mund ta bëjë shumë më të vështirë për bizneset e vogla të krijojnë kursime dhe të kenë akses në kredi.

Por për shkak të adoptimit të gjerë të teknologjive dixhitale dhe celulare, peizazhi i pagesave po ndryshon. Transaksionet me para në dorë janë në rënie dhe ka një zhvendosje drejt aktivitetit dixhital – një tendencë e përshpejtuar nga pandemia COVID-19, kur transaksionet në internet u rritën. Duke pasur parasysh këto zhvillime të mëdha është e domosdoshme që të punojmë për të zvogëluar ndarjen dixhitale në rritje. Bankat qendrore dhe politikëbërësit tani kanë një mundësi për të eksploruar reformat, duke përfshirë emetimin e parave dixhitale të bankës qendrore për të gjithë.



<https://www.bis.org/speeches/sp220418.htm>

Monedhat Dixhitale të Bankave Qendrore (CBDC) për njerëzit

CBDCs (Central Bank Digital Currencies) for the People

Op-ed

18 prill 2022

Z. Agustín Carstens, Drejtor i Përgjithshëm i BIS

H.M. Mbretëresha Máxima e Holandës, Avokatja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Financat Gjithëpërfshirëse për Zhvillim

... Vijon

CBDC-të mund të ofrojnë një mundësi për të kapërcyer disa pengesa me të cilat përballen personat akses në sistemin bankar. Shërbimet tradicionale kanë kosto dhe kërkesa mbrojtëse siç janë tarifat e transaksioneve, bilancet minimale të llogarisë ose prova formale e identifikimit. Pengesat shtesë përfshijnë nivelin e ulët të besimit në pagesat dixhitale dhe mungesën e telefonave inteligjentë të disa grupe të popullsisë.

Monedhat dixhitale të Bankave Qendrore (CBDC) nuk janë mënyra e vetme për të kapërcyer këto pengesa, ato mund të jenë pjesë e paketës së mjeteve të përfshirjes financiare. Bankat qendrore tashmë po koordinojnë përmirësime të mëtejshme për pagesat me pakicë duke adoptuar sisteme pagesash të shpejta dhe CBDC-të përfaqësojnë një shtrirje të natyrshme të kësaj vazhdimësie. Si sistemet e pagesave të shpejta ashtu edhe CBDC-të mund të nxisin ofrues konkurrues që të sjellin shërbime të reja, kosto më të ulëta dhe, në fund të fundit, të zgjerojnë aksesin. Një përfitim i mëtejshëm i CBDC-ve është se, për nga natyra e tyre, ato do të përfshijnë avantazhet unike të bankës qendrore - sigurinë, përfundimin, likuiditetin dhe integritetin.

CBDC-të mund të anashkalojnë shumë nga interesat tregtare që janë shfaqur rreth sistemeve të pagesave dhe kanë kontribuar në mungesën e efikasitetit dhe koston për përdoruesit. Ato gjithashtu mund të ulin kostot duke hequr rreziqet e kreditit dhe likuiditetit të cilat janë të trashëguara në format e tjera të parasë dixhitale. Një CBDC ka potencialin për të përmirësuar dhe lidhur sistemet e pagesave - brenda dhe jashtë kufijve. Ajo mund të nxisë vendet me infrastrukturë të kufizuar financiare që të kalojnë drejtpërdrejt në një marrëveshje CBDC, duke krijuar një mundësi për t'u lidhur me një sistem pagesash gjithëpërfshirës, të sigurt dhe efikas.

Përfitimet e tjera lidhen me politikat sociale, p.sh. qeveritë mund të përdorin CBDC për të kanalizuar mbështetjen financiare për familjet me të ardhura të ulëta, gjë që do të zgjeronte përfshirjen afatgjatë dhe do të vepronte si një portë tjetër për shërbime të tjera financiare.

Vijon ...



<https://www.bis.org/speeches/sp220418.htm>

Monedhat Dixhitale të Bankave Qendrore (CBDC) për njerëzit

CBDCs (Central Bank Digital Currencies) for the People

Op-ed

18 prill 2022

Z. Agustín Carstens, Drejtor i Përgjithshëm i BIS

H.M. Mbretëresha Máxima e Holandës, Avokatja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Financat Gjithëpërfshirëse për Zhvillim

... *Vijon*

Për të realizuar këto përfitime, çdo prezantim i CBDC duhet të shoqërohet me politika reformatore dhe masa mbrojtëse për të adresuar vështirësitë dhe rreziqet e mundshme, të tilla si nivelet e ulëta të edukimit financiar dhe dixhital, dhe sfidat operacionale, duke përfshirë edhe sigurinë kibernetike. Gjithashtu, reformat duhet të parandalojnë ndërprerjen e ndërmjetësimit: rrezikun që paratë do të mbahen në sasi të mëdha në kuletat e CBDC, në vend të depozitave në bankat tregtare, duke i bërë ato të padisponueshme për huadhënie (siç janë hipotekat) dhe qëllime të tjera produktive.

Bankat qendrore gjithashtu duhet të konsiderojnë hartimin e CBDC-ve për të barazuar fushën e lojës. Jepuni njerëzve kontroll mbi të dhënat e transaksioneve të tyre dhe aftësinë për t'i ndarë ato me një grup më të gjerë ofruesish të shërbimeve financiare. Shqetësimet në rritje në lidhje me privatësinë e të dhënave mund të adresohen duke integruar mbrojtjen e të dhënave personale në strukturën e një CBDC.

Bankat qendrore që eksplorojnë CBDC-të do të kenë shumë zgjedhje për të bërë për të balancuar mbrojtjen e privatësisë dhe transparencën, si dhe për të siguruar përfshirjen financiare dhe integritetin financiar. Ata do të duhet të marrin në konsideratë nëse do t'u japin akses të drejtpërdrejtë konsumatorëve ose do të përdorin një model thjesht të ndërmjetësuar që ofron portofoli dixhital CBDC përmes bankave ose ofruesve të shërbimeve financiare jo-bankare. Më shumë dialog, kërkime dhe prova do të nevojiten për të treguar se si CBDC-të mund të bëhen më së miri motorët e përfshirjes financiare.

Bankierët qendrorë dhe përfaqësues të tjerë të sektorit publik kanë për detyrë të sigurojnë që sistemi financiar të jetë gjithëpërfshirës, i hapur, konkurrues dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave të të gjitha grupeve. Nëse projektohen siç duhet, CBDC-të premtojnë shumë për të ndihmuar në mbështetjen e një sistemi financiar dixhital që funksionon për të gjithë.



<https://www.bis.org/speeches/sp220418.htm>



REPORTING AND GOVERNANCE

How financial firms can turn cloud rules to their advantage

Christopher Hinitt | April 20, 2022



Financial services regulators are turning their attention to cloud resilience and security. How can they use new cloud regulations to their advantage? By Christopher Hinitt, digital banking expert at PA Consulting.

Supply chain risks

Financial institutions benefit from cloud's scalability, cybersecurity controls and access to AI and machine learning. For the past decade, cloud has been the enabling factor behind financial product innovation. Cloud regulation or consultations on regulations are anticipated in the UK this year, which will encourage vital focus on digital supply chain risks: cloud cybersecurity and operational and concentration risks.

Most Viewed

ESG regulations: what financial institutions need to know in 2022

Expect 2021 to be a busy year for European regulation

Even 'bank-friendly' CBDCs could prove disruptive

Gibraltar working on update to digital rules

A practical approach to EU sustainable finance

@RiskRegulator

Follow us on Twitter

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/How-financial-firms-can-turn-cloud-rules-to-their-advantage>

Si firmat financiare mund t'i kthejnë rregullat e "Cloud" në avantazhin e tyre

(How financial firms can turn cloud rules to their advantage)

Christopher Hinitt

Ekspert i bankave dixhitale në PA Consulting

Rregullatorët e shërbimeve financiare po e drejtojnë vëmendjen e tyre te qëndrueshmëria dhe siguria e "Cloud". Si mund të përdorin rregullat e reja të "Cloud" në avantazhin e tyre?

Institucionet financiare përfitojnë nga shkallëzueshmëria e "Cloud", kontrollat e sigurisë kibernetike dhe qasja në Inteligjencën Artificiale IA. Për dekadën e fundit, "Cloud" ka qenë faktori që ka mundësuar inovacionin e produkteve financiare.

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut nga Komisioni Bullgar i Mbikëqyrjes Financiare, FSC, tregu bullgar i sigurimeve e mbylli vitin 2021 me një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 3.24 miliardë BGN ose rreth 1.66 miliardë euro. Kjo vlerë shpreh një rritje prej 12.73% krahasuar me një vit më parë. Sigurimet e Jo-Jetës vijnë të zënë pjesën më të madhe me pothuajse 81.29% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 1.35 miliardë euro me rritje vjetore 8.23%. Sigurimet e Jetës zunë 18.71% të primeve të shkruara bruto, rreth 310.59 milionë euro, që shpreh një rritje prej 37.58% krahasuar me një vit më parë.

ÇEKI

www.xprimm.com

Në fund të vitit 2021, sipas shifrave të fundvitit, të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, CNB, tregu i sigurimeve në Republikën Çeke arriti në 179.80 miliardë CZK ose rreth 7.22 miliardë euro. Ky vëllim i primeve të shkruara bruto shpreh një rritje prej 6.92% më shumë se viti i kaluar.

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 101.91 miliardë CZK, ose rreth 4.09 miliardë euro, me një rritje me 10.78 krahasuar me vitin 2020. Nga volumi i dëmeve 61% lidheshin me sigurimet e Jo-Jetës dhe 39% lidheshin me nënklasat e sigurimit të Jetës.

Në sigurimin e Jetës, duke përfshirë dhe risigurimin, vlera e primeve të shkruara bruto mbeti thuajse në nivelin e vitit 2020, me rreth 51.70 miliardë CZK, ndërsa vlera e dëmeve dhe dëmshpërblimeve të paguara - përfshirë ndryshimin në bilancin e provigjioneve teknike, arriti në 39.57 miliardë CZK.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara në Raportin Vjetor 2021 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto, në fund të vitit 2021, në tregun rumun të sigurimeve arriti në mbi 2.87 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej rreth 21.9% më shumë se viti 2020.

Pjesën më të madhe të primeve, prej 82% e zë sektori i sigurimeve të Jo-Jetës. Klasat e sigurimit motorik (Sigurimi Kasko dhe MTPL) përbëjnë afërsisht 76% të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës dhe 62% të primeve në total në vitin 2021. Në vlerë absolute, primet e shkruara bruto për sigurimin motorik arritën në 1.78 miliardë euro, nga të cilat 1.23 miliardë euro i përkasin MTPL-së.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave vjetore të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, NBS, në fund të dhjetorit 2021, tregu sllovak i sigurimeve arriti në vlerën e 2.15 miliardë euro, ose 3.34% më pak se një vit më parë.

Volumi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jetës ra me 2.56% duke arritur vlerën e 911.73 milionë euro. Policat e sigurimit të Jetës zënë rreth 42.42% të tregut total të sigurimeve. Ndërsa klasat e sigurimit të Jo-Jetës zunë 1.23 miliardë euro, ose rreth 57.58% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto, por duke shënuar një rënie me 3.92%

Në përgjithësi, vlera e dëmeve të paguara nga siguresit vendas është ulur me 7.80% krahasuar me një vit më parë duke arritur në 1.16 miliardë euro. Nga kjo vlerë, 627.48 milionë euro kanë të bëjnë me pagesa të dëmeve për kontratat e sigurimit të Jetës. Pagesat e dëmeve kanë qenë më të shumta për klasat e sigurimeve motorike - 214.57 milionë euro; sigurimi Kasko 188.89 milionë euro dhe 84.21 milionë euro, ishin pagesa për kontratat e dëmeve mbi zjarrin dhe dëmet e tjera të pronës.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fund të vitit të publikuara nga Shoqata Sllovene a Sigurimeve, tregu slloven arriti në 2.60 miliardë euro në fund të vitit 2021, duke shënuar një rritje prej 1.5% krahasuar me vitin e kaluar.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës pësuan një ulje prej -1.2% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur vlerën e 740 milionë euro. Sa i përket dëmeve të paguara, vlera e përgjithshme e tyre ishte 1.63 miliardë euro, nga të cilat rreth 511.5 milionë euro ishin dëme të paguara për kontratat e sigurimit të Jetës, 539.8 milionë euro pagesa për kontratat e sigurimit shëndetësor, 354.2 milionë euro ishin pagesa për dëme në sigurimet motorike (MTPL dhe sigurimi Kasko) dhe rreth 120 milionë euro, ishin dëme të paguara për sigurimit e pasurisë.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al